
Dokumente Tenderi

1. KRITERET E PËRGJITHSHME

Ofertuesi duhet të deklarojë sipas Shtojces 3 bashkelidhur, se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislationit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës bashkëlidhur dokumenteve.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Deklaratën mbi permbushjen e specifikimeve teknike sipas Shtojcës 1 bashkelidhur.
- b. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 2 bashkelidhur.

Oferta ekonomike më e favorshme:

Për kriteret vlerësuese më poshtë keni të përcaktuara peshën specifike të secilit kriter dmth sa pikë do të ketë cdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteret e Vleresimit

(A) Afati i levrimit i propozuar

Pikët

[0-60]

Pl- Pikët për Levrimin

Lu- Levrimi me i shkurter i ofruar

L – Levrimi i Radhës (*duke filluar nga levrimi më i shkurter*)

$$Pl = 60 \times Lu / L$$

(Levrimi me i shkurter = pikët maksimale për levrimin e ofruar)

(B) Oferta ekonomike e paraqitur

[0-40]

Vlerësimi ne total i ofertes ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Po- Pikët për Oferten financiare

Ou- Oferta më i Ulët financiare

O – Oferta e Radhës financiare (*duke filluar nga oferta më e ulët financiare*)

$$Po = 40 \times Ou / O$$

(Oferta me e ulet financiare = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Do te jete shumatorja e pikeve te marra per (A) + (B)

Operatori ekonomikë që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4 bashkelidhur.

1. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë: Ofertuesi duhet të paraqesë, Autorizimin për tregtim të pajisjeve mjekësore të leshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas ligjit 89/2014 "Për pajisjet mjekësore".

2. Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese ose *vetëdeklarim të distributorit të autorizuar* (të plotësohet në formularin e ofertes).

3. Ofertuesi duhet të jete i certifikuar dhe të paraqesë ISO 9001: 2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore" për tregtim, instalim, mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore ose ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme dhe të ëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare, akreditues të njohur nga RSH, të përkthyer dhe të noterizuar.

4. Ofertuesi duhet të paraqesë certifikate konformiteti CE për artikullin e ofruar, sipas direktivave përkatëse të vlefshme të përkthyer dhe të noterizuara.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Kompania Prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga Prodhuesi për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikullit të ofruar.

6. Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit përkatës.

7. Kërkohen të paraqitet katalogë teknikë ku të përfshihen specifikimet teknike të artikullit të ofruar. Në katalogë, specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. Katalogët kërkohen të përkthyer në gjuhën shqipe vetem në pjesën teknike përkatëse.

8. Deklarate për përmbushjen e afatit të garancisë. (Dy vite garanci përfshirë blerjen dhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmrimi të reja dhe origjinale).

9. Deklarate që pajisjet e ofruara janë të reja të një prodhimi original dhe të teknologjisë së viteve të fundit.

10. Vetëdeklarim me anë të së cilës Ofertuesi deklaron se ofron disponueshmëri të pjesëve të këmbimit për të paktën 5 vjet në rast se autoriteti kontraktor do të ketë nevojë për to.

11. Operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë afatin e levrimit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.